



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RREHIT GJYQËSOR DURRËS

Numri i Ceshtjes :	71041-00718-11-2015	Data e Regjistrimit :	22/04/2015
Numri i Vendimit:	11-2015-3194	Data e Vendimit :	30/06/2015

VENDIM

NË EMËR TË REPUBLIKËS

GJYKATA E RREHIT GJYQËSOR DURRËS E PËRBËRË NGA:

GJYQTAR: Tritan Hamitaj

SEKRETARE: Tritan Hamitaj

Sot më datë 30/06/2015mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

Kërkues {...} i biri i {...} dhe i x, i datëlindjes {...}

Objekti:Heqja e mase se sekuestros preventive vënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durres me vendim nr.125 date 12.03.2015.

Baza Ligjore:Neni 274/3 i K.Pr.Penale.

Gjykata dëgjoji palët që kërkuan:

Përfaqësuesjae kërkuesit:Revokimin e vendimit, heqjen e sekuestros.

Prokurori: Rrëzimin ekërkesës.

Personiinteresuar:Në çmim të Gjykatës.

Gjykata pasi analizoi provat dhediskutoi çështjen në tërësi,

VEREN :

Vëren: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës ka regjistruar procedimin penal nr 1272/2012 në ngarkim të {...}, dyshuar se ka kryer veprën penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtari kriminale" parashikuar nga neni 287 të K.Penal.

Në datën 6.3.2015 Prokuroria ka paraqitur kërkesën për vendosje sekuestro preventive për pasuri të paluajtshme në pronësi të {...} duke pretenduar se:

Shtetasi {...} i datëlindjes {...}, lindur në Shijak dhe banues në {...}

Durrës, është dënuar me vendimin nr. 946/2009 SIEP datë 30.11.2009 të Gjykatës së Milanos në Itali me 7 vjet e 6 muaj burg për veprën penale të "Favorizimit të emigracionit klandestin" në bashkëpunim dhe njëkohësisht ndaj tij ka edhe një urdhër arresti nga Gjykata e Monxas/Itali me nr. 70/7 R.E.S. datë 09.02.2002 për kryerje të veprave penale "Dhunë seksuale", "Akte të turpshme", "Grabitje në rrethana rënduese", "Mbajtje armësh zjarri". Mbi bazën e këtyre vendimeve të gjykatës shtetasi {...}

është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Roma/Itali dhe më datë 07.06.2013 është arrestuar për efekt ekstradimi, proces që nuk ka përfunduar ende.

Nga shkresa me nr. 49/14 prot datë 12.07.2013 e Prokurorisë së Përgjithshme që ka transmetuar materialet për efekt ekstradimi, nga ku rezulton se shtetasi {...} është dënuar nga Gjykata e Apelit të Milanos më datë 29.11.2007 që është bërë përfundimtar më datë 07.10.2009, me 7 vjet e 6 muaj burgim për veprat penale të organizatës kriminale që synon shfrytëzimin e prostitucionit dhe të tjerë. Episodet për të cilat është deklaruar fajtor dhe dënuar shtetasi {...}, kanë ndodhur në periudhën 1999 deri në vitin 2003. Në këto episode shtetasi {...} del si drejtues i

organizatës që vepronte në Milano e Puglia, dhe që merrej që me futjen në mënyrë klandestine në territorin e shtetasit Italian të grave me origjinë nga Evropa Lindore me qëllim prostituimi në formën e detyrimit, favorizimit dhe shfrytëzimit të prostitucionit. Si drejtues i organizatës në fjalë të hollat e siguruara nga ky aktivitet kriminal merreshin dhe i dërgoheshin atij në Shqipëri ({...}). Ky i fundit sipas provave në gjykim, me të ardhurat e marra kishte blerë disa shtëpi në Shqipëri.

Po kështu nga letërporositë e ekzekutuar e të ardhur me shkresën me nr. 1642 prot datë 25.06.2014 ka rezultuar se:

Shtetasi {...} është njohur në Itali si person edhe me emrin {...}, referuar pasaportës së paraqitur prej tij kur është ndaluar nga ana e policisë italiane. Në Itali shtetasi {...} është identifikuar si autor grabitje me dhunë për një rast të identifikuar në shumën 500.000 lireta dhe për shfrytëzim prostitucioni. Dhe për këtë të fundit ka patur proces gjyqësor ndaj shtetasit {...} mbi bazën e të cilit ka dalë vendimi i sipërpërmendur. Bashkëlidhur është dërguar urdhëri i ekzekutimit të vendimit të gjykatës italiane në fjalë që ka urdhëruar burgosjen e këtij shtetasi me qëllim shlyerjen e dënimit me 7 vjet 6 muaj burgim dhe 103.000 euro gjobë.

Nga verifikimet e kryera në territorin italianë në isntitucionet përkatëse, ka rezultuar se shtetasi {...} dhe as familjarë të tij nuk kanë paraqitur asnjëherë deklaratë të të ardhurave dhe nuk rezultojnë bashkëlidhur të dhëna të tipit pasuror apo kontraktor. Po kështu për këtë shtetas dhe familjarë të tij nuk rezultojnë llogari rrjedhëse, transaksione të pasurive të patundshme të tanishme apo të mëparshme dhe as automjete të regjistruar në emër të tyre. Ka vetëm tre deklaratatë eksporti të automjeteve të përdorura për periudhën 2012/2013 të drejtuara në territorin shqiptar një farë {...}, për të cilin evidencat dokumentare nuk japin të dhëna personale të hollësishme. Sipas deklaratave të eksportit të sjellë nga autoritetet italiane rezulton se automjetet janë në vlerën 500 euro, 900 euro dhe 1600 euro.

Nga verifikimet e kryera ka rezultuar se shtetasi {...} ka pasuri në vlera të konsiderueshme në emër të tij, për të cilat dyshohet se mund të kenë lidhje me veprimtarinë kriminale të kryer në Itali për të cilat është dënuar. Veprat penale për të cilat është dënuar dhe ajo për të cilën është nxjerrë urdhër

arresti janë vepra penale të cilat kryhen për qëllime përfitimi material.

Sipas përgjigjes nr. 40/1 prot datë 12.01.2015 Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale ka dërguar një kopje të njehsuar me origjinalin të lejes së legalizimit të dhënë më datë 25.06.2009 për vetëdeklarimin e shtetasit {...}, e quajtur si objekt:

"{...}" me adresë {...}. Sipas lejes së legalizimit rezulton se

është bërë legalizimi i një sipërfaqe toke prej 6949 m², sipërfaqe ndërtimi 2012.7 m², sipërfaqja prej 4286.47 m² është sipërfaqe për ushtrim aktiviteti, ndërtimi është mbi tokë i ndarë në 3 kate – me emërtim sipas vetëdeklarimit në datë 25.08.2006 "{...}"; ndërtim dy kate – me emërtim sipas vetëdeklarimit të datës 25.08.2006 "{...}"; ndërtim një katë me emërtim "{...}"- një katë sipas vetëdeklarimit të datës 25.08.2006; pishinë sipas vetëdeklarimit të datës 25.08.2006; qendër sportive (Motel 2 dhoma) sipas vetëdeklarimit të datës 25.08.2006; Qendra Sportive Kal?eto sipas vetëdeklarimit të datës 25.08.2006; magazinë një kat sipas vetëdeklarimit të datës 25.08.2006; – të gjitha këto të ndërtuara mbi sipërfaqen në pronësi të shtetasit {...} që ndodhet në zonë kadastrale me nr. 3255 dhe numër pasurie 179/35 në {...}. Gjithashtu përveç sa më sipër, në këtë leje është theksuar se brenda pronës është pishina me sipër.366.36 m², kal?eto me sipërfaqe 128 m². Sipas dokumentacionit që ndodhet në dosjen e lejes së legalizimit në fjalë, vlera e invenstimit është përlllogaritur në shumën 172.807.501 lekë. Pas legalizimit pasuria sa më sipër, është regjistruar në emër të shtetasit {...} me nr. Pasurie 179/35 në volumn nr. 9, faqe 168, zk.3255 me adresë {...}

{...} ka të regjistruar në ZVRPP Durrës:

- pasuria me nr. 179/35 vol.9 fq.168 zk.3255 – arë+truall me sipërfaqe 6949 m² e ndodhur në Sallmone, Shijak brenda të cilës ka një ndërtim me sipërfaqe 2012.7 m², me datë regjistrimi 05.10.2006 – për këtë sipërfaqe në kartelë përshkruhet se ndodhet një kompleks shërbimesh –supermarket, magazinë, disko, palestër, dhomë zhveshje, kalceto, pishinë. Kjo është pasuria për të cilën është dhënë leja e legalizimit të sipërpërmendur.

Qendra Kombëtare e Rregjistrimit Tiranë me shkresën nr. 15910/1 prot datë 11.09.2012 ka sjellë informacion se:

- {...} është administrator në shoqërinë "{...}" sh.p.k. me NIPT {...} e

rregjistruar që në datë 13.12.2002. Në fillim administrator dhe ortak {...} deri në vitin 2006 që për shkak të vdekjes së këtij të fundit kapitali themeltar është ndarë midis bashkëshortes dhe fëmijëve të tij dhe si administrator është caktuar i vëllai {...}. Objekti i shoqërisë – Tregëtim me shumicë dhe pakicë, import – eksport të artikujve të llojeve të ndryshëm, transport mallrash, pikë servisi. Tregti e karburanteve me pakicë, vajra lubrifikante dhe të gjitha nënproduktet e tyre.

- {...} është administrator dhe ortak i vetëm në shoqërinë "{...}" sh.p.k. e

rregjistruar që në datë 18.06.1999. Objekti i shoqërisë – Import – eksport me shumicë e pakicë të mallrave industriale, kinkaleri, ushqimore, hidrosanitare, druri, elektroshtëpiake, veshëmbathje, ilace, lëndë të para për industrinë, pjesë këmbimi, kancelari, pajisje shtëpiake.

- {...} është administrator në shoqërinë "{...}" sh.p.k. me numër NIPT {...}

Për këtë subjekt për shkak të mos plotësimit të të dhënave nuk mund të thuhet se është i njëjti me atë të rregjistruar në datë 18.06.1999.

- Shtetasit {...} dhe {...} figurojnë të jenë ortakë dhe administratorë

në shoqërinë "{...}" shpk, regjistruar me vendim të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë nr. 16747 datë 22.01.1997. Objekti i shoqërisë – Import – eksport me shumicë e pakicë të mallrave industriale, kinkaleri, ushqimore, hidrosanitare, druri, elektroshtëpiake, veshëmbathje, ilace, lëndë të para për

industrinë, pjesë këmbimi, kancelari, pajisje shtëpiake.

• Shtetasit {...}figuron të jetë administratorë në shoqërinë "{...}" shpk, me numër NIPT-i {...} dhe "{...}" shpk, me NIPT {...}. Për këtë subjekt për shkak të mos plotësimit të të dhënave nuk mund të thuhet se është i njëjti me atë të regjistruar me vendim të Gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë nr. 16747 datë 22.01.1997. Për këtë shoqëri sipas shkresës me nr. 13442/2 prot datë 31.07.2013 të Drejtorisë së Tatimeve Durrës rezulton se shoqëria e parë është regjistruar më datë 06.02.1997 dhe ?regjistruar më datë 27.02.1998 dhe e dyta regjistruar më datë 22.05.1998 dhe kaluar në pasiv më datë 22.05.1998..Gjithashtu po në këtë shkresë është informuar se për të dy subjektet në fjalë nuk ka të dhëna dhe deklarime të tjera lidhur me bilance dhe pasqyra financiare.

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. 19270 prot datë 26.09.2012 ka kthyer përgjigje se rezultojnë këto të dhëna për subjektet e regjistruar: NIPT {...} me administrator {...}

; NIPT {...} me administrator {...}, NIPT {...}me administrator {...}

. Për këtë shoqëri sipas shkresës me nr. 13442/2 prot datë 31.07.2013 të Drejtorisë së Tatimeve Durrës rezulton se shoqëria e parë është regjistruar më datë 06.02.1997 dhe ?regjistruar më datë 27.02.1998 dhe e dyta regjistruar më datë 22.05.1998 dhe kaluar në pasiv më datë 22.05.1998. Gjithashtu po në këtë shkresë është informuar se për të dy subjektet në fjalë nuk ka të dhëna dhe deklarime të tjera lidhur me bilance dhe pasqyra financiare.

Nga pasqyrat financiare të marra për këto shoqëri rezulton se nga viti 2003 deri në vitin 2006:

Fitimet në neto - për vitin 2003 - 2006 për shoqërinë "{...}" sh.p.k. janë përlogaritur në shumën {...} dhe për periudhën 2006 – 2012 janë përlogaritur në shumën {...}; në total shuma prej {...} fitimet në neto— për vitin 2009 – 2012 për shoqërinë "{...}" sh.p.k. janë përlogaritur në shumën {...}.

Nga banka {...}ka rezultuar se:

1. Subjekti {...} shpk me administrator {...} i është dhënë kredi nga ish banka {...} me date 11/07/2003 për shumën {...} për qëllim biznesi për të përdorur për aktivitetin tregëtar të importit të mallrave për një afat prej 90 ditësh;

2. Me date 09/09/2003, ish {...} ka lidhur marrëveshje për ndryshim kontrate me subjektin {...}shpk me administrator {...} në bazë të ciles sipas kërkesës së shoqërisë {...} shpk i është dhënë një rritje e linjes së kredise së dhënë me date 11/07/2003 nga {...} në {...} , pra i është rritur vlera e kredise me {...} me shume se ajo e muajit Korrik të vitit 2003

; 3. Me date 18/12/2009 Banka {...}i ka dhënë shoqërisë {...}shpk me administrator {...}shumën e kredise {...}, e dhënë për qëllimin e financimit të pjesëshëm të kostos së investimit për kompleksin e tregëtisë dhe shtëpive Sallmone Durrës nga kjo shume e marrë kredi është likuajduar deri në shtator të vitit 2012 shuma {...}, shuma e pa paguar është

4. Me date 29/04/2011 Banka {...} i ka dhënë shoqërisë {...}shpk me administrator {...} shumën e kredise v e dhënë për qëllimin e mbylljes së linjes së kredise me afat pra të overdraftit që është dhënë në vitin 2003 nga {...} shoqërisë {...} shpk(për shumën {...}). Kjo shume e marrë kredi prej {...} deri në shtator të vitit 2012 është likuajduar në shumën prej {...} deri në muajin shtator të vitit 2012 dhe shuma e pa likuajduar e kredise deri në muajin shtator të vitit 2012 është e barabartë me {...}

Subjektit {...}shpk i është akorduar nga ish {...} linjë kredie me afat në formë overdrafti në shumën {...} për qëllim biznesi shume e cila ka qenë në llogarinë bankare të

subjektit prane ish bankes {...} dhe nuk eshte marre cash kjo kredi, por eshte perdorur nga ana e subjektit per aktivitetit tregtar.

Likujdami i kesaj shume kredise me afat e cila ka qene overdraft i bankes eshte likujduar per shumen {...} nga depozita e lene peng nga {...} dhe shuma {...} euro eshte bere me ane te kredise bankare e dhene me date 29/04/2011 nga shoqeria perfaqesuar nga {...}. Kjo kredi bankare eshte e mbyllur nga ana e shoqerise {...} shpk deri ne muajin Shtator te vitit 2012 kur eshte bere rregjistrimi i ketij procedimi.

Shuma e kredise bankare prej {...} i eshte dhene subjektit "{...}" shpk ne baze te ciles ajo ka kryer aktivitetin tregtar te importit te mallrave nga jashte shtetit nga Italia, transfertat bankare qe jane kryer ne llogarin e shoqerise bejne fjale per likujdim e faturave te bera blerje nga subjekti {...} per periudhen nga viti 2003 deri ne vitin 2009.

Ne lidhje me burimin e te ardhurave qe kane sherbyer per te likujduar shumat e kredive te marra ne fund te vitit 2009 dhe i vitit 2011 i referohem aktivitetit tregtar te kryer nga subjekti {...} shpk nga viti 2003 deri ne vitin 2012 dhe per subjektit {...} shpk nga viti 2009 deri ne vitin 2012. Ne baze te pasqyrave financiare te ketyre shoqerive rezulton se aktiviteti i tyre nder vite ka qene me nje fitim neto ne shumen {...}

Burimet e te ardhurave per likujdimet e kesteve te kredive:

- Per linjen e kredise se pare dhene ne forme overdrafti ne shumen {...} likujdimi i kesaj shume eshte bere me depoziten e lene peng ne shumen {...} nga {...} ne banke, ndersa diferenca ne shumen {...} eshte paguar me kestin e kredise te marre ne muajin Prill te vitit 2011 nga {...};

- Per linjen e kredise te dhene me date 18/12/2009, per investim dhe linjen e kredise date 29/04/2011, si burim i likujdimit jane te ardhurat nga {...}, te cilat nuk kane gjeneruar nga aktiviteti i tatueshem i shoqerise, pasi nga viti 2010 deri ne vitin 2011 aktiviteti i subjektit te tregetise ka qene me fitim neto ne shumen ({...} + 1{...} + {...}) ne total i barabarte me {...}leke e cila nuk ka qene e mjaftueshme per te likujduar kestet e kredive per periudhen nga viti 2010 deri ne vitin 2012 te cilat kane qene ne shumen {...}ose $1\{...\}(\{...\} \times \{...\} = \{...\} \text{lek})$.

Në këtë konkluzion arrihet duke pasur parasysh rezultatet e verifikimit të të ardhurave në Shqipëri, por edhe në Itali. Kështu më konkretisht për sqarimin e fakteve lidhur me këtë procedim është kërkuar verifikimi i të ardhurave të krijuara në Itali nga shtetasi {...}, {...} dhe familjarëve të shtetasit {...}, nëpërmjet letërposisë dhe nga aktet në ekzekutim të letërporosisë së ardhur me shkresën nr. 2905/1 prot datë 21.08.2014 e Prokurorisë së Përgjithshme, nga ku ka rezultuar se: nuk ka konfirmime të profilit financiar me inisiativë të tyre apo të deleguara autoriteteve gjyqësore në ngarkim të {...} dhe familjarëve të tij.

Në vazhdim në lidhje me pasuritë e vetëdeklaruar për legalizim, i ashtuquajtur kompleks, nga perpunimi i te dhenave, rezulon se sipas dokumentacionit të marrë nga ALUIZN, vlera e investimit te kompleksit eshte e barabarte me {...}.

Nga dokumentacioni i sjellë nga ana e ALUIZN-it rezulton se objektet që përbëjnë kompleksin në pronësi të shtetasit {...}, rezulton se janë ndërtime të para vitit 2006- kohë kur është bërë vetëdeklarimi për legalizim. Nga verifikimi i të ardhurave të shtetasit {...} rezulton se ai nga shoqëria {...} sh.p.k. nga del burimi i vetëm i të ardhurave rezulton të ketë patur nga viti 2003 (koha e fillimit të aktivitetit të shoqërisë) deri në vitin 2006 kohë kur është bërë vetëdeklarimi i këtyre objekteve në kompleks, në shumën {...}, ?ka tregon se për mosjustifikim me të ardhura për ndërtimin e këtij kompleksi.

Pra, nisur nga sa më sipër rezulton se ka dyshime për kryerjen e veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale" të parashikuar nga neni 287/1-b të K.penal të kryer nga shtetasi {...} . Kjo pasi ka dyshime se ky shtetas ka pastruar paratë e fituara nga shfrytëzimit të prostitucionit – për të cilën është dënuar, duke ndërtuar kompleksin. Ndërtimi i këtij kompleksi me paratë e fituara nga aktiviteti krimianl i shfrytëzimit të prostitucionit, tregon qartë se jemi para rastit kur mund të themi se kompleksi në fjalë të konsiderohet produkt i veprës penale dhe si i tillë mbi të duhet të vendoset sekuestro preventive për pasurinë me nr. 179/35 në volumin nr. 9, faqe 168, zk.3255 me adresë {...}}, - "Kompleks Shërbimesh "{...}" me sipërfaqe toke prej 6949 m2, sipërfaqe ndërtimi 2012.7 m2, dhe sipërfaqe aktiviteti prej 4286.47 m2.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin Nr. 125 datë 17.3.2015 ka vendosur:

"Pranimin e kërkesës sipas N.274 të K.Pr.Penale.

Vendosjen e sekuestros preventive, mbi pasurinë me Nr.179/35, vol.9, fq.168, zona kadastrale Nr.3255, e ndodhur në fshatin Sallmone Durrës, me sipërfaqe toke 6949 m 2, si dhe sipërfaqen ndërtimore 2012.7 m 2, të ndodhur brenda kësaj sipërfaqe toke, në pronësi të {...}."

Në kërkesës për heqjen e sekuestros preventive kërkuesi parashtroi:

Kane ndryshuar kushtet e zbatimit të këtij vendimi gjyqësor, konform pikës 3 të nenit 274 të K.Pr.Penale.

Se pari: Vendosja e sekuestros preventive është e lidhur me kryerjen e një veprë penale që në rastin konkret nuk ekziston.

Kjo masë është marrë mbështetur në shkresën nr.49/14 data 12.7.20 13 të Prokurorisë së Pergjithshme e cila konfirmon se Gjykata e Apelit e Milanos në data 7.10.2009, ka bërë perfundimtar vendimin gjyqësor me të cilin {...} është denuar me 7 vjet e 6 muaj burg, per veprat penale të organizatës kriminale që synon shfrytëzimin e prostitucionit, per episode që kane ndodhur në periudhen 1999 deri në vitin 2003.

Neni 287/1 i K.Penal, parashikon si masë dënimi burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Ndërsa sipas nenit 66/b të K.Penal "Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në castin e marrjes së personit si të pandehur kane kaluar:

b)dhjetë vjet për krimet qe parashikojne dënime nga pese deri në dhjetë vjet burgim.

Sipas kësaj dispozite ligjore efektet e parashkrimit të ndjekjes penale fillojnë nga momenti i krverjes se veprës penale e deri ne çastin e marrjes së personit si i pandehur.

Vepra penale e pastrimit të produkteve të vepres penale e parashikuar nga neni 287 i K.P, e lidh ekzistencën e saj detyrimisht me kohën e kryerjes së veprës penale dhe jo me kohën kur është regjistruar çeshta ne organin procedues.

Referuar provave shkresore që ndodhen në dosjen gjyqësore, të cilat janë pasqyruar edhe në arsyetimin e vendimit të gjykates per sekuestro, rezulton se veprat penale të kryera nga shtetasi {...}, i perkasin periudhave 1999 deri në vitin 2003 (shih shkresat e Prokurorisë së

Pergjithshme nr.49/14 data 12.07.2013, në te cilën citohet vendimi i Gjykates së Apelit të Milanos).

Edhe pse pretendohet nga organi i akuzës se ndaj këtij shtetasi është regjistruar ceshtja penale me nr.1272/2012 per vepren penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal ai ende edhe sot nuk është pyetur dhe marrë si i pandehur per këte vepër penale.

Per rrjedhojë konform edhe nenit 66/b të K.Penal ndjekja penale ndaj këtij shtetasi per vepren penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal është parashkruar e nuk mund te ndiqet penalisht..

Duke mos qene e mundur ndjekja penale per nenin 287 të K.Penal per shtetasin {...}per

shkak të parashkrimit, nuk mund të vendoset sekuestro preventive mbi pasuritë e tij per shkak te kesaj

vepre penale.

Se dyti: Nuk është i saktë përfundimi që ka arritur kjo gjykatë që evidentohet në pjesën arsyetuese të vendimit "{...}" është arrestuar në datë 7.6.2013, për efekt ekstradimi, proces që nuk ka përfunduar ende"

Rezulton se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, me datë 7.6.2013, ka regjistruar me nr.(6 1014-00714)330, kërkesën për vlerësim si të ligjshëm të arrestit në flagrance të shtetasit {...} dhe caktimi njëkohësisht si masë shtrënguese ndaj tij "Arrest me burg" me qëllim ekstradimi.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.(1 1-2013-3086) 30 datë 8.6.2013 ka vendosur: "-Te vlerësoje të ligjshëm arrestimin e shtetasit{...}.

-Të caktoj si masë sigurimi ndaj shtetasit {...} atë të "detyrimit për t'u paraqitur në Policinë Gjyqësore ", të henen e pare dhe të tretë të çdo muaji, ora 14:00, parashikuar nga neni 234 iKPr.P"

Me pas Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës me datë 31.7.2013, regjistron me nr.(7 101300879)288 datë 31.07.2013 kërkesën me objekt ekstradimin e shtetasit{...}.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr.(1 1-2013-4065) datë 3 1.07.2013 ka vendosur: "-.Te mospranoje kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës -Refuzimin e ekstradimit të shtetasit shqiptar {...} nga Shqipëria në Itali si të pabazuar në prova dhe në ligj"

Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr.10-2013-1518(240) datë 22.10.2013 të Gjykatës së Apelit Durrës, si dhe nga Gjykata e Lartë me vendimin nr.00-2014-1479 (134) datë 7.5.2014.

Këtë vendim Gjykata kryesisht e ka mbështetur në argumentin se ekstradimi i {...} nuk mund të ekstradohej pasi ishte shkelur parimi i përgjithshëm ndërkombëtar, ai i standartit i të dhënave të rëndësishme të fajësive, si kusht (sine qua non) standarde këto që janë parashikuar në Konventën Europiane të Ekstradimit të vitit 1957 dhe dy protokollat shtesë, Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë e datës 13.10.1957 etj

Nga përmbajtja e këtij vendimi si dhe vendimit të Gjykatës së Lartë nr.278 datë 18.09.2000 është provuar se Gjykata e Apelit në Milano ka renditur se faktet për të cilat ai është denuar në Itali kanë ndodhur në datën 8.09.2000, Nëntor 2000, 15 Dhjetor 2000 dhe 12.1.2001.

Por njëkohësisht Gjykata e Lartë me vendimin nr.278 datë 18.9.2000, ka vërtetuar se shtetasi {...} nga data 04.10.1999 dhe deri me datë 18.09.2000 ka qenë i paraburgosur pranë dhomave të paraburgimit të Drejtorisë së Policisë në Durrës.

Në këto rrethana Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka konkluduar se "Nuk rezultojnë të dhëna të rëndësishme të fajësive, si kusht që mund të lejohej ekstradimi".

Mbi këtë bazë Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës me shkresën nr.12685 datë 31.10.2014 ka bërë njoftimin për heqjen nga kërkimi të shtetasit {...} dhe sikundër është thënë në vendimin e gjykatës që po kundërshtojmë se procesi nuk ka përfunduar ende.

Në këto rrethana konform nenit 274/3 të Kodit të Procedurës Penale të hiqet sekuestro preventive e vendosur mbi pasurinë me nr.179/35, vol 9, f.168, ZK 3255 e ndodhur në fashatin Salimone Dunes, me sipërfaqe totale 6949 m² si dhe sipërfaqe ndërtimore 2012.7 m² të ndodhur brenda kësaj sipërfaqe. Në gjykim Gjykata kërkoi informacion nga ZVRRPP Durrës nëse prona e sekuestruar ishte ende me kufizime pronësie ose jo.

Nga përgjigja nr 7254/3 datë 2.6.2015, Zyra vendore informon gjykatën se kjo pasuri është vënë në hipotekë në favor të Bankës {...} për shlyerjen e një kredie.

Gjykata me vendim të ndërmjetëm futi si palë të tretë Bankën {...} meqenëse tërhiqte pasojat nga vendimmarrja.

Në gjykim përfaqësuesja e bankës parashtroi se "{...}" shpk ka marrë në vitin 2009 kredi në shumrën {...}, me afat deri në 31.12.2016. Më pas kjo kredi është ristrukturuar me afat përfundimi të kredisë deri në 11.5.2018. Vendimmarrja e gjykatën nuk ndikon në heqjen e hipotekës.

Në gjykim u morën si prova:

1-Kontrata e shitblerjes se nje siperfaqe toke prej 2070 m2 e ndodhur ne ZK. 3255,vol 5,fq.42 me nr. rep193,koL 54 dt.16.7.1999;

2-Kontrata e shitblerjes se nje toke prej 1980 m2 te ndodhur ne ZK. 3255,vol 5 fq.54 me nr. rep 194,kol 55 dt.16.7.1999;

3-Kontrata e shitblerjes se nje toke m sip. Po prej 2070 m2, me nr .rp 1295,kol m56 dt. 16.7.1999.

4- Kontrata e huase nga ku rezulton se {...} ka marre hua nga shtetasi {...} shumen prej {...}, ne te cilen eshte permendur fakti se keto leke jane marre hua per ndertimin nje godine 3 kateshe;

5-Kontrata e Kredise me nr. Rep.838 kol 288 me banken {...} per shumen {...}. Ne kete kontrate del qarte se kredimarrese eshte shqeria {...}shpk;

5-Marrëveshja per ndryshimin e kontrate se kredise se mesiperme sipas se cilës kredia behet per 500 mijë euro;

6-Kontrata e lidhur ndermjet {...} dhe firmes zbatuese per aspirimin e supermarketit e lidhur ne dt. 28. Janar 1998 per fazen e pare te punimeve ne shmen 25000 mijë dollar;

7- Kontrata per reklamat e lidhur me {...} sh.a ne dt. 4.4.2001;

8-Polic sigurimi nga zjarri per objektin supermarket me nr. 00 15 80 dt. 10.9.2004, lidhur me shoqërinë "Atlantik" sha me nr serie 001580;

9-Kontrata shërbimi interneti qe mban dt.28.2.2001;

10-Fatura me nr. 11742 dt. 13.3.1998 per ardhjen nga Bari I Italise materiale ndertimi per kompleksin qe po ndertohej;

11- 13 fatura te blerjes se mallrave per objektet e komplksit {...};

12- Dokumenti doganor me nr. 000195/M DT. 19.01.2001 ne tre flete qe tregon per mallrat e ardhura nga importi per llogar te kompleksit '{...};

13-6 fatura e blerjes se mallrave per keto objekte;

14- Projekti i supermarketit dt. 20.1. 1998;

15- Guidat e qytetit te Durresit te viteve 2003 dhe 2004;

16-CD të {...} viti 2003.

Prokurori kërkoi rrëzimin e kërkesës duke argumentuar se vepra penale e parshikuar nga neni 287 i K. Penal është një vepër permanente e cila edhe sot ajo quhet duke u kryer.Vepra është kryer nga viti 1999 deri në 2003 dhe pastrimi ka vazhduar që do të thotë që kjo vepër nuk l nënështrohet parashtrimit. Lidhur me argumentin tjetër që ky object është përfunduar në vitiin 2003 nuk është bindës, pasi është provuar me prova shkresore se ndërtimi është bërë më vonë. Momenti i bërjes së objektit përputhet me momentin e kërkesës për legalizim.

Gjykata cmon se kërkesa është e drejtë dhe duhet pranuar.

Masat e sigurimit paraqiten në Titullin V të K. Pr. Penale dhe caktimi i tyre është në funksion të ndjekjes penale dhe në funksion të objektit ndahen në disa Kre. Kreu VI i masave të sigurimit lidhet me sekuestrimin e pasurive të personave që janë në ndjekje penale.

Neni 274 i K. Pr. Penale parashikon:

1. Kur ka rrezik që disponimi i lirë i një sendi që lidhet me veprën penale mund të rëndojë ose të zgjasë pasojat e saj ose të lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera, me kërkesën e prokurorit, gjykata kompetente urdhëron sekuestrimin e tij me vendim të arsyetuar.

2. Sekuestroja mund të vendoset edhe për sendet, produktet e veprës penale dhe çdo lloj pasurie tjetër që lejohet të konfiskohet, sipas nenit 36 të Kodit Penal.

3. Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata, me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron.

Gjykata në vazhdimin e lënies në fuqi apo të revokimit të masës së sekuestros preventive cmon se pretendimi i kërkuesit se vepra penale është parashkruar duhet të trajtohet nga kjo gjykatë, pasi masat e sigurimit nuk mund të qëndrojnë në fuqi nëse ndjekja penale nuk mund të vazhdoj. Masat e sigurimit janë në funksion të hetimit dhe gjykimit të çështjes dhe të personit nën hetim.

Pretendimi i kërkuesit se vepra penale është parashkruar është i drejtë dhe i bazuar në nenin 66/b të K. Penal dhe në provat e marra në këtë shqyrtim gjyqësor.

Në vendosjen e masës së sekuestros gjykata ka krijuar dyshime për kryerjen e veprës penale të "Pastrimit të produkteve të veprës penale" të parashikuar nga neni 287/1-b të K. Penal të kryer nga shtetasi {...}. Ky dyshim ka qenë se ka pastruar paratë e fituara nga shfrytëzimi i prostitucionit për të cilën është dënuar në Itali, dhe duke ndërtuar kompleksin ka humbur origjinën e tyre. Ndërtimi i këtij kompleksi me paratë e fituara nga aktiviteti krimianal i shfrytëzimit të prostitucionit, konsiderohet produkt i veprës penale.

Kjo masë është marrë mbështetur në shkresën nr.49/14 data 12.7.2013 të Prokurorisë së Pergjithshme e cila konfirmon se Gjykata e Apelit e Milanos në data 7.10.2009, ka bërë perfundimtar vendimin gjyqësor me të cilin {...} është dënuar me 7 vjet e 6 muaj burg, për veprat penale të organizatës kriminale që synon shfrytëzimin e prostitucionit, për episode që kanë ndodhur në periudhën 1999 deri në vitin 2003.

Pretendimi i prokurorit se pastrimi i produkteve është bërë në momentin e paraqitjes së kërkesës për legalizim është i pabazuar.

Ligjet nr.9304, datë 28.10.2004 "Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale" dhe nr.9209, datë 23.3.2004 "Për legalizimin e shtesave në ndërtime" janë miratuar në Kuvend në datën 23.3.2004 e më pas, dhe asnjë person që kishte ndërtuar pa leje nuk kishte mundësi të deklaronte një ndërtim të tillë. Ky ligj parashikon legalizimin e ndërtimeve të bëra pa leje para nxjerrjes së tij dhe në këto kushte pretendimi i prokurorit është i pabazuar.

Nga provat e marra në këtë shqyrtim gjyqësor rezulton se ndërtimi dhe mobilimi i kompleksit të sekuestruar është bërë nga viti 1998 deri në vitin 2003. Nga viti 2001 ka filluar në funksion pjesërisht, dhe nga viti 2003 e më pas rezulton se kompleksi ndërtimor ka qenë në funksion të plotë dhe ka kryer shërbime.

Nga policia e sigurimit nga zjarri për objektin supermarket me nr. 00 15 80 dt. 10.9.2004, lidhur me shoqërinë "{...}" sha me nr serie 001580, provohet se në datën 10.9.2004 kompleksi "{...}", ka qenë në funksion dhe kryente shërbime, dhe për këtë shkak është siguruar.

Nga kontrata për reklamë lidhur midis {...} dhe "{...}" rezulton se {...}

ka transmetuar reklamë për këtë kompleks për periudhën 4.4.01 deri 3.5.2001, provë kjo e shoqëruar me mandat arkëtimi në favor të {...}, dhe oraret e transmetimit të reklamës.

Kjo provë tregon se objekti ka qenë në funksion dhe kontrata e reklamës është zbatuar nga {...}

Nga deklaratat doganore të vitit 2001 rezulton se kërkuesi ka zhdoganuar pajisjet e shërbimit të të kuzhinës etj. Me këto deklarata provohet se objekti ka përfunduar para këtyre deklaratave dhe ka qenë duke u pajisur me sendet e nevojshme për vënien në funksion të objektit të aktivitetit.

Nga përgjigja e ALUIZNI Durrës me nr 3222/1 prot datë 18.10.2012 rezulton se kërkuesi ka plotësuar 8

formular vetëdeklarimi. Nga përgjigja rezulton se të gjitha ndërtimet në Sallmone janë përpara vitit 2000. Për këto vetedeklarime është dhënë leja e legalizimit me nr 1574 datë 25.6.2009 të ndërtuar në tokë të vet, pasuri e cila është venë sekuestro preventive.

Nga vërtetimi i pronësisë datës 12.12.2002 , datë 29.7.1999, datë 29.7.1999, datë 17.7.1999, lëshuar nga ZVRPP Durrës të ndodhura në fashikullin 4 të dosjes së vendosjes së sekuestros preventive, rezulton se sipërfaqja e tokës mbi të cilën është ndërtuar objekti rezulton e blerë nga kërkuesi dhe regjistruar para vitit 2002.

Neni 287/1 i K.Penal, parashikon si masë dënimi burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.

Ndërsa sipas nenit 66/b të K.Penal "Nuk mund të bëhen ndjekje penale kur nga kryerja e veprës deri në castin e marrjes së personit si të pandehur kane kaluar:

b)dhjetë vjet për krimet qe parashikojne dënime nga pese deri në dhjetë vjet burgim.

Sipas kësaj dispozite ligjore efektet e parashkrimit të ndjekjes penale fillojnë nga momenti i kryerjes se veprës penale e deri ne castin e marrjes së personit si i pandehur.

Nga aktet e dosjes së vendosjes së sekuestros preventive dhe provat e marra në këtë shqyrtim gjyqësor rezulton se kërkuesi nuk është marrë i pandehur. Po të marrim për bazë datën e këtij vendimi 30.6.2015 dhe të llogarisim se në këtë datë kërkuesi nuk është marrë i pandehur, vazhdimi i ndjekjes penale për veprën penale të cilën akuzohet kërkuesi e ka afatin e fundit të kryerjes së veprës 30.06.2005, datë në të cilën mbushet 10 vjet sipas nenit 66/b të K. Penal.

Nga të gjitha provat e mara në këtë shqyrtim gjyqësor dhe në shqyrtimin gjyqësor të vendosjes së sekuestros preventive rezultoi se ndërtimi i objekteve, mobilimi dhe blerja e tokës nën objekt janë bërë përpara datës 60.6.2005.

Fakti penal i pretenduar nga prokuroria ka qenë vetëm objekti dhe toka, nuk ka qenë edhe pastrimi i fitimeve të nxjerra nga ky investim. Me këtë pretendim të akuzës nuk mund të themi se pastrimi i produkteve është një krim vazhdues, pasi nuk është objekt hetimi penal dhe fitimet e këtij aktiviteti. Fakti penal i humbjes së origjinës së parave të rrjedhura nga krimi është vetëm për objektin dhe tokën fakt që ka ndodhur përpara 30.6.2015

Pretendimi tjetër i prokurorit se kjo vepër është e paparashkrueshme në përputhje me nenin 287/3 të K. Penal është i pabazuar në ligj.

Neni 287/3 parashikon:

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;

b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashkruar ose amnistuar;

c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;

ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;

d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënueshme, si në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë.

Dijenia dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana fakti objektive.

Pastrimi i produkteve të veprës penale sipas ligjit penal të kohës të parashikuar nga neni 287/3 të K.

Penal nga ana objektive kërkon në mënyrë kumulative, ekzistencën e një vepre penale, ekzistencën e produkteve të saj, dhe së fundi pastrimin e këtij produkti në një nga format e parashikuara nga neni 287/1 të K. Penal. Pra kërkon një vepër mëmë dhe një tjetër të dytë pas saj e cila nuk mund të rri në

m.ënyrë autonome.

Parashkrimi i ndjekjes penale parashikohet në nenin 66 të K. Penal, si dispozitë e pjesës së përgjithshme të K. Penal dhe nuk mund të jetë në pjesën e posaçme në nenin konkret ku parashikohet vepra penale.

Në nenin 67 të K. Penal parashikohet në mënyrë shteruese se cilat janë veprat penale të cilat nuk parashkruhen dhe në të nuk parashikohet neni 287 i K. Penal.

Por edhe si është ndërtuar Neni 287/3 nuk vjen në kundërshtim me neni 67 të K. Penal. Ligjvënësi me nenin 287/3 ka rregulluar anën objektive të veprës së parashikuar në nenin 287/1 të K. Penal, duke parashikuar dënimin e personit që pastron produkte, edhe në rastet kur vepra mëmë është kryer por personi për të nuk mund të dënohet. Në këtë rast prokuroria dhe gjykata duhet të hetojnë për kryerjen e veprës mëmë dhe pasi të arrijnë në përfundimin se është kryer një vepër penale që ka sjell produkt të saj, atëherë ju del si detyrë të provojnë dhe pastrimin e këtyre produkteve.

Për rrjedhojë konform nenit 66/b të K.Penal ndjekja penale ndaj këtij shtetasi për veprën penale të parashikuar nga neni 287 i K.Penal është parashikuar e nuk mund të ndiqet penalisht..

Duke mos qene e mundur ndjekja penale për nenin 287 të K.Penal për shtetasin {...} për shkak të parashkrimit, nuk mund të qëndroj vazhdimi i sekuestros preventive. Gjykata cmon se jemi përpara ndryshimit të kushteve të zbatimit të sekuestros preventive dhe në bazë të nenit 274/3 të K. Pr. Penale duhet të revokohet.

Mjafton ky fakt për Gjykatën për të pranuar kërkesën e Kërkuesit, pavarësisht pretendimit të dytë për rënien nga fuqia të vendimit të dënimit në Itali. Është e vërtetë se kërkuesi nuk është ekstraduar në Itali dhe vendimi i gjykatave shqiptare për mos ekstradim ka vene në dyshim fajësinë e kërkuesit me rrëzimin e kërkesës duke arsyetuar se në një periudhë kohe ai ka qenë i arrestuar në Shqipëri ndërkohë që është dënuar se edhe në këtë kohë ka kryer veprën penale në Itali duke qenë atje.

Vendimi i dënimit në Itali vërtet krijon një dyshim të arsyeshëm, por kërkuesi paraqiti kontratën e huasë datë 21.6.1995 midis tij dhe {...} për një shumë prej {...}, qëllimi i kësaj huaje ka qenë për ndërtimin e kompleksit, nga prokuroria argumentohet se kërkuesi ka aktivitet tregtar që nga viti 1999, megjithatë këto fakte duhen vlerësuar në shqyrtimin në themel të akuzës nëse do ngrihet një e tillë.

Për këto arsye

Baza Ligjore:Gjykata në bazë të neneve 378 e vijues të K.Pr.Penale,

VENDOSI:

Vendosi:

Pranimin e kërkesës të kërkuesit {...}, në bazë të N.274 pika "3" të K.Pr.Penale.

Heqjen e sekuestros preventive mbi pasuritë me Nr.179/35, vol.9, fq.168, zona kadastrale Nr.3255, e ndodhur në {...}, me sipërfaqe toke {...}m², si dhe sipërfaqen ndërtimore 2012.7 m², të ndodhur brenda kësaj sipërfaqe toke, në pronësi të {...}

Kundër vendimit mund të bëhet ankim brenda 10 ditëve nga e nesërmja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Durrës. Për personat e interesuar afati i ankimit i fillon nga momenti i marrjes dijëni.

- U shpall në Durrës me 30/6/2015, ora.11.05

SHPENZIMET GJYQESORE

Kërkesëpadia	0
Taksa Gjyqësore	200
Noterizime	0
Njoftime	0
Akt ekspertimi	0
Avokat	0
Gjithsej	200

GJYQTAR:
Tritan Hamitaj